

**PROJEKT:**

**MONITORIMI I SHPENZIMEVE TË BUXHETEVE DHE PARTIVE POLITIKE NË PERIUDHËN  
PARAZGJEDHORE DHE ZGJEDHORE**

**RAPORT MUJOR**

**PËR PERIUDHËN: PRILL 2016**

**Mbështetur nga:**

**SHKUP, MAJ 2016**



**Kingdom of the Netherlands**

**PËRMBAJTJA:**

<b>PËRMBLEDHJE</b>	<b>3</b>
<b>1. PROCESI ZGJEDHOR</b>	<b>3</b>
<b>2. AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE (ASHMAA)</b>	<b>4</b>
<b>3. PROTESTA</b>	<b>5</b>
<b>4. VMRO-DPMNE</b>	<b>6</b>
<b>5. LSDM</b>	<b>6</b>
<b>6. BDI</b>	<b>7</b>
<b>7. REKLAMIMI I PAGUAR NË FACEBOOK/SHTABE LOKALE</b>	<b>7</b>
<b>8. AKTIVITETE TË PARTIVE MË TË VOGLA PARTIAKE</b>	<b>7</b>
<b>9. SHPENZIME TË PËRAFËRSHME</b>	<b>7</b>
<b>10. MONITORIM I SHPENZIMEVE BUXHETORE NË PERIUDHËN PARAZGJEDHORE</b>	<b>11</b>
<b>11. KORRESPONDENCË</b>	<b>15</b>
<b>ANEKSE</b>	<b>20</b>

## PËRMBLEDHJE

Gjatë muajit prill, ekipi monitorues i TI-Maqedoni, QAE dhe partnerët e organizatave lokale, kanë shënuar ulje të aktiviteteve të partive politike në kuptim të fushatës politike dhe promovim të programeve të tyre në tetë rajonet. Nuk ka zyra të reja lokale të hapura ose aktivitete tipike për fushatë zgjedhore (mitingje, debate, materiale promovuese).

Kuvendi u shkarkua më 06.04.2016, pas një vendimi paraprak politik për zgjedhje të reja parlamentare të parakohshme më 26 prill. Për shkak të problemeve me listën zgjedhore, zgjedhjet ishin shtyrë për herë të dytë, tani më 5 qershor. Ditët vijuese ishin shënuar me Vendimin e Kryetarit të shtetit më 13 prill, për largimin dhe ndërprerjen e gjitha procedurat për 56 funksionarë të lartë dhe politikanë dhe Vendimin e Kryetarit të Parlamentit më 15.06.2016 për caktimin e zgjedhjeve parlamentare të parakohshme më 5 qershor. Këto dy ngjarje, dhe veçanërisht abolimi i politikanëve, ka rezultuar me demonstrata në Shkup dhe ditëve vijuese protestat përhapen edhe në qytetet më të mëdha të vendit.

Në periudhën pas vlerësimit të parë të shpenzimeve të partive politike (mes 07.03.2016-30.04.2016) vlerësimet vijuese të shpenzimeve të mundshme janë shënuar nga ekipi ynë:

1. Grumbullime para Gjykatës Kushtetuese – përafërsisht gjithsej janë harxhuar 1.230.000.00 MKD;
2. Promovimi i programit të partive politike – gjithsej janë harxhuar rreth 1.572.000.00 MKD;
3. Protesta dhe grumbullime qytetare – gjithsej janë harxhuar rreth 4.270.000.00 MKD.

Gjatë këtij muaji korrespondenca me pushtetin lokal dhe qendror është ulur paksa dhe 19 KIKP ishin dërguar dhe ishin marrë 14 përgjigje.

### **Deklarata për publikun në ueb faqet e Qeverisë:**

Për dallim nga raportet paraprake, ka një tendencë të uljes së numrit të publikimeve, gjatë muajit prill, ndërsa rritje të numrit të thirrjeve publike për 13% në krahasim me numrin e thirrjeve publike në mars.

Përmbajtja e deklaratave është me të dhëna modeste cilësore dhe sasiore – gjegjësisht përqindja e informacioneve të publikuar mes gjitha institucioneve të vëzhguara (ku ka publikime në ueb faqe / mendime) është në nivel të ultë.

## **1. PROCESI ZGJEDHOR**

Më 06.04.2016 Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Trajko Veljanovski, ka shkarkuar Kuvendin, pa praninë e opozitës LSDM. Vendimi për caktimin e zgjedhjeve të parakohshme

parlamentare ka vijuar menjëherë pas disa ditëve, më 15.04.2016 (figura 1).

## **2. AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE (ASHMAA)**

- Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele do të bëjë monitorimin e Mbulimit mediatik të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, duke filluar nga 15.04.2016. Ekipi monitorues i Agjencisë dhe disa bashkëpunëtorë të jashtëm do të jenë në programe 24 orësh në televizionet kombëtare dhe radio në baza ditore. Në pajtim me Metodologjinë për Monitorim të Mbulimit Mediatik të Zgjedhjeve, në programet e radiove dhe televizionit, lëndë e monitorimit, gjatë periudhës së caktimit të zgjedhjeve deri në fillimin e fushatës zgjedhore, do të jenë dy stacione televizive dhe radio që do të përdorin shërbimet e servisit radio-difuziv dhe të Shërbimit Parlamentar Radiodifuziv, programet e pesë televizioneve, pesë televizioneve satelitore, katër televizioneve kabllovide dhe dy radio kombëtare komerciale. Të gjitha televizionet dhe radiot që do të transmetojnë program të paguar politik gjatë fushatës zgjedhore, duhet të përcaktojnë çmimet e tyre më së voni deri më 19 prill 2016, të martën, ashtu që çmimi për një sekondë të reklamimit të paguar politik nuk duhet të tejkalojë çmimin mesatar për reklamim, që kalkulohet gjatë tre muajt e fundit nga dita e caktimit të zgjedhjeve. Çmimoret duhet të dorëzohen Agjencisë, Komisionit Shtetëror Zgjedhor, Enti Shtetëror për Revizion dhe Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Komisionit. Sipas Kodit Zgjedhor, radiodifuzerët duhet të publikojnë çmimoret e tyre për reklamim të paguar politik në programet e tyre në listë dy herë para fillimit të fushatës zgjedhore. Secili ndryshim i çmimoreve nuk është i lejuar gjatë kohës së procesit zgjedhor.

- Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele në Raportin e tyre për përfaqësim mediatik në dhjetë ditët e para nga dita e caktimit të zgjedhjeve, ka arritur konkluzionin që; Disa medie nuk respektojnë parimet e programit të shfaqjes objektive dhe të paanshme të ngjarjeve, siguri të trajtimit të ndryshëm, qëndrime të barabarta për respektimin e dinjitetit njerëzor, nxitje të frymës së tolerancës dhe për pavarësinë e politikës redaktuese. Agjencia paralajmëron që nëse disa prej medieve vazhdojnë të transmetojnë mbulime në të cilat lidhen politikatat e shtetit, me masat të programeve zgjedhore të partive politike dhe të njoftojnë për aktivitete të organeve shtetërore në nivelin qendror dhe lokal në mënyrë që mund të jetë në funksion të përfaqësimit mediatik zgjedhor të cilido subjekt politik, do të ndërmarrën masa zgjedhore.

### 3. PROTESTA

Kryetari i Republikës së Maqedonisë, Gjorge Ivanov ka publikuar Vendimin për ndalim të gjitha procedurave kundër politikanëve dhe mbështetësve të tyre që takojnë partive të kundërshtuara, që ka rezultuar me demonstrime në Shkup, dhe ditëve vijuese janë përhapur edhe në qytetet tjera të vendit (figura 2).

- Demonstrata kundër Vendimit për Abolim të politikanëve janë të organizuar nga iniciativa qytetare “PROTESTOJ” me praninë e anëtarëve partiak dhe simpatizues të partisë politike LSDM, partisë politike LEVICA, organizata të shumta qytetare (AJDE, MERITOJMË MË MIRË, SOLIDARITET, LENKA). Mijëra qytetarë të pakënaqur dhe të irrituar, kanë marshuar në rrugët duke bërë thirrje: “Nuk ka drejtësi, nuk ka paqe”. Demonstruesit kanë vazhduar me ngjyrosjen e fasadave të institucioneve, shumica e tyre të rinovuar në stilin barok në kuadër të projektit Shkupi 2014, ashtu që kjo lëvizje dhe demonstruesit në rrugë kanë marrë emrin Revolucioni Laraman. Vëzhguesit tanë kanë vërejtur që në ditët 13, 14 dhe 21 prill, qytetarët e qyteteve tjera në vend kanë ardhur për mbështetje të demonstratave, me transport të organizuar me autobusë (68 autobusë gjithsej për këto ditë, të vërejtur nga vëzhguesit). Shpenzime më të vogla janë bërë për zërim, distinktivë, flamuj dhe ngjyrë. Demonstratat kanë vazhduar edhe në Shkup dhe qytete tjera të Maqedonisë: Manastir, Tetovë, Gostivar, Ohër, Resnjë, Prilep, Kumanovë, Shtip, Strumicë, Gjevgjeli, Delçevë, Veles, Shtip, Kavadar dhe Koçan (figura 3).

- Nga ana tjetër, GDOM-Lëvizja Qytetare për Mbrojtjen e Maqedonisë (LQMM) organizon kundër protestë në Shkup dhe në qytete tjera të Maqedonisë, me praninë e mbështetësve të partisë politike VMRO-DPMNE, për mbështetje të datës për zgjedhje më 5 qershor. Numri i autobusëve të mbështetësve të LQMM nga qytetet tjera, që ishte vërejtur nga vëzhguesit tanë, ka arritur në 240 (gjithsej) për ditët 13, 14 dhe 21 prill, ndërsa shpenzime tjera ishin gjithashtu të vërejtur: zërim, skenë, program muzikor dhe flamur. Kundër protestat u përhapën edhe në qytetet tjera të Maqedonisë: Manastir, Ohër, Resnjë, Prilep, Kumanovë, Strumicë, Gjevgjeli, Veles dhe Kavadar. Një pjesë e administratës publike janë nën presion për të marrë pjesë në demonstratat e lëvizjes qytetare LQMM. Kjo zhvillohet në orarin e punës me transport të organizuar deri në vendin ku zhvillohen këto demonstrata. Në ueb faqen tonë “prijavi korupcija” kemi regjistruar rate të frikësimit të personave, me qëllim të pjesëmarrjes në kundër protestë në Shkup dhe kemi reaguar në mënyrë përkatëse me letër tek Prokurori Publik (figura 4).

- Më 22 prill protesta ishin organizuar nga partitë e vogla politike shqiptare dhe shoqata në Shkup: Lëvizja për reforma PDSH, RDK, Shoqata e ish të burgosurve politik dhe të persekutuar shqiptarë të UÇK dhe të shoqërisë qytetare, kundër vendimit për ndalimin e gjitha procedurave kundër politikanëve dhe mbështetësve të tyre, që takojnë në palët e kundërshtuar nga ana e kryetarit Ivanov. Lëvizja për reforma PDSH i organizon anëtarët e tyre me 15 autobusë, kryesisht, nga pjesa veriperëndimore e vendit, duke filluar nga Struga deri në Kumanovë (figura 5).

#### **4. VMRO-DPMNE**

Partia politike VMRO-DPMNE ka vazhduar me promovimin e projekteve qeveritare, duke përzier aktivitetet e qeveritare me ato partiake. Anëtarët e partisë dhe kryetari i partisë promovojnë projekte qeveritare në vend dhe në ueb faqen zyrtare të partisë: Mega-projekt i ir në bujqësi me të cilën janë parashikuar 3 milion euro nga buxheti (i promovuar nga kryetari i partisë Nikolla Gruevski); projekt i Ministrisë së Shëndetësisë: Ko-financim i personave në specializim që punojnë në klinika private (promovuar nga ministri i shëndetësisë Nikolla Todorov); projekte të reja të Ministrisë së Arsimit: Bursa për studime të magistraturës në Akademinë e Filmit në Ohër, dhe projekti: “Projekti për zhvillim të shkathtësive dhe mbështetje të inovacioneve” – prezantuar nga zëvendës ministri i arsimit Spiro Ristovski. Projekti “Maqedonia punëson” – promovuar nga Agjencia për Punësim (UFR i VMRO-DPMNE dhe Rinia Demokratike Evropiane). Kryetari i VMRO-DPMNE, Nikolla Gruevski në Muzeun e Luftës Maqedonase ka prezantuar projektin e ri “Nga qyteti në fshat”.

#### **5. LSDM**

Katërmbëdhjetë parti opozitare kanë nënshkruar Platformën për Demokraci të udhëhequr nga Lidhja Socialdemokrate dhe e kanë konfirmuar vendimin e tyre për bojkot të zgjedhjeve të parakohshme, që do të zhvillohen më 5 qershor. Përveç LSDM, në zgjedhjet nuk do të marrin pjesë as: PRSD, PLD, të Bashkuar për Maqedoninë, Partia për lëvizjen e Turqve dhe nëntë parti tjera. Platforma paraqet një bashkim të partive nën idenë për medie të lira, zgjedhje të rregullta dhe demokratike, gjyqësor të pavarur, sundim i të drejtës dhe luftë kundër krimit dhe korrupsionit.

## **6. BDI**

Partia politike BDI ka zhvilluar pesë ngjarje gjatë kësaj periudhe; në ditët 4, 6, 9, 10 dhe 18 prill në Sallën Diplomatike të Panairit të Shkupit ka vazhduar prezantimin e programit “Propozim programi për 2016-2020”. BDI ka zhvilluar një debat për decentralizimin dhe zhvillimin rajonal; kulturën; mediet dhe sektorin qytetar; politikën sociale dhe mbrojtjen shëndetësore.

## **7. REKLAMIMI I PAGUAR NË FACEBOOK/SHTABE LOKALE**

Siç përmendëm më lartë, gjatë muajit prill, fushata politike është në qetësi. Ekipi ynë nuk ka vërejtur hapje të zyrave të reja lokale dhe reklamimi i paguar politik në Facebook është zvogëluar relativisht.

## **8. AKTIVITETE TË PARTIVE MË TË VOGLA PARTIAKE**

Ekipet tona kanë vërejtur aktivitet të rritur të partive më të vogla politike: (BESA-lëvizja qytetare-debat në hotel Drim në Strugë më 02.04.2016), Partia Liberale ka hapur një seli të re në Manastir; PDSH-lëvizja për reforma ka mbajtur një takim me përfaqësuesit e Odës Ekonomike të Maqedonisë Veriperëndimore, partia Fuqi Demokratike të Romëve ka shënuar Ditën Ndërkombëtare të Romëve në Qendrën për Kulturë në Kumanovë).


## **9. SHPENZIME TË PËRAFËRSHME**

Nga 07.03.2016 deri në këtë moment, nuk kemi vërejtur ngjarje të mëdha në të cilat janë vërejtur shpenzime buxhetore ose shpenzime të partive politike. Më poshtë keni listën e shpenzimeve që janë bërë sipas ngjarjeve të ndryshme:

#### a. GJYKATA KUSHTETUESE

Më 16 mars ishin zhvilluar protesta dhe kundër protesta para Gjykatës Kushtetuese, si reagim i Gjykatës Kushtetuese për Vendimin e Ligjit për Amnistion.


- Protestat ishin organizuar nga organizata qytetare “AJDE” me mbështetjen e partisë politike LSDM, kundër vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Shpenzimet për transport të organizuar e autobusë ishin vlerësuar rreth 420.000.00 MKD (30 autobusë, zërin, transparente).
- Në kohën e njëjtë, partia politike GROM, ka organizuar kundër protestë para Gjykatës Kushtetuese, duke dhënë mbështetje gjykatësve kushtetues për Vendimin. Përafërsisht, shpenzimet e tyre janë vlerësuar rreth 810.000.00 MKD (60 autobusë, zërim, tenda, sandviçë)





## b. PROMOVIMI I PROGRAMEVE


- Partia politike VMRO-DPMNE për promovim të “PËRGJEGJSHMËRISË” së tyre në sallën sportive “Jane Sandanski” në Shkup, kanë shpenzuar 1.340.000.00 MKD (marrje me qira të sallës, zërim, LED ekrane, skenë, materiale të shtypura).
- Partia politike LSDM për promovim të programit të tyre në Kumanovë, në Pallatin e Kulturës “Trajko Prokopiev” kanë shpenzuar 60.000.00 MKD (marrje me qira dhe zërim).
- Partia politike BDI për promovim të programit të tyre “Propozim programi 2016-2020) në Sallën Diplomatike të panairit të Shkupit kanë shpenzuar 172.000.00 MKD (marrje me qira për 7 ngjarje dhe zërim).



### c. PROTESTA

Demonstratat fillimit kanë nisur me Vendimin e kryetarit Ivanov për abolim të politikanëve. Protestuesit kanë kërkuar dorëheqje të kryetarit Ivanov dhe tërheqje të Vendimin për abolim të politikanëve, shtyrje të datës së zgjedhjeve, kyçje të anëtarëve të sektorit qytetar në vendimet për zgjedhjen e krizës dhe njësi special gjyqësore pranë Gjykatës Penale. Kundër protestuesit kanë kërkuar zhvillim të zgjedhjeve më 5 qershor. Në protestat ishin të pranishëm edhe mbështetës të partive politike: LSDM, LEVICA; ndërsa në kundër protestat ishin mbështetësit e partive politike VMRO-DPMNE, GROM.

- Lëvizja qytetare LQMM për kundër protestat e organizuar më 13, 14 dhe 21 prill kanë shpenzuar mbi 3.180.000.00 MKD (240 autobusë, 3 herë zërim, skenë, program muzikor).
- Iniciativa qytetare “PROTESTOJ” kanë shpenzuar 850.000.00 MKD për ditët 13, 14 dhe 21 prill (68 autobusë, zërim, skenë).
- Anëtarët e Lëvizjes për reforma PDSH kanë zhvilluar protestë me 22.04.2016 dhe përafërsisht shpenzimet janë vlerësuar në rreth 240.000.00 MKD (15 autobusë, flamuj).



## 10. MONITORIM I SHPENZIMEVE BUXHETORE NË PERIUDHËN PARAZGJEDHORE

### Pushteti qendror

#### Monitorim i indikatorëve për ndjekjen e shpenzimeve buxhetore në nivelin qendror

- ✓ Realizimi kumulativ i deficitit buxhetor deri në muajin mars 2016 ka qenë 30% që paraqet pothuaj 5 herë realizim më i madh nga realizimi i pritur i barabartë (25%).
- ✓ Deri në muajin mars, realizimi kumulativ i pikës letra shtetërore ka qenë 29% nga gjithsej buxheti i planifikuar, që ngjashëm me deficitin buxhetor, është pothuaj se 4 herë më e madhe në krahasim me realizimin e pritur të barabartë në nivelin mujor prej 25%.
- ✓ Të dalat kapitale në mënyrë kumulative deri në mars 2016 kanë realizim prej 12% që është pothuaj se ½ (rreth 13 herë realizim më i ultë) nga realizimi i pritur i barabartë mujor.
- ✓ Norma kumulative e realizimit deri në mars të dalave për ndihmë sociale është 22%, dhe rreth 3 herë nën realizimin e supozuar të barabartë mujor (kumulativ) prej 25%.
- ✓ Pika – transferime tjera është realizuar në mënyrë kumulative deri në muajin mars prej 29%, që është pothuaj se 4 herë nën realizimin e barabartë mujor. Norma e realizimit të kësaj pike vetëm në muajin mars paraqet 11%.
- ✓ Norma mujore e realizimit të të dalave për mallra dhe shërbime në mënyrë kumulative deri në mars është 20%, dhe rreth 5 herë mbi realizimin e supozuar të barabartë mujor prej 25%.
- ✓ Norma kumulative mujore e realizimit të pikës transferime sociale ndaj Agjencisë për Punësim (përfshirë edhe kompensime për të papunët, shpenzime për masat për punësim ,etj.) deri në mars është 19%, dhe rreth 6 herë nën realizimin e supozuar të barabartë mujor.
- ✓ Deri në muajin mars, realizimi kumulativ i pikës huamarrje të huaja ka qenë 9,3% nga gjithsej buxheti i planifikuar, që ngjashëm me deficitin buxhetor, është pothuaj se 15,7 herë më e madhe në krahasim me realizimin e pritur të barabartë në nivelin mujor prej 25%. Gjatë interpretimit të të dhënave të kësaj pike duhet të kemi parasysh aspektin ciklik të shprehur në realizimin varësisht nga periudha në të cilën është bërë huamarrja e huaja dhe shuma e plotë.
- ✓ Të hyrat nga taksat administrative dhe gjobat deri në muajin mars (ndonëse në krahasim edhe me muajin janar) në mënyrë kumulative janë realizuar 20.4%, që paraqet 4.6 herë

realizim më të ultë nëse në mënyrë të barabartë do të realizohej buxheti në këtë pikë çdo muaj gjatë vitit.

- ✓ Norma kumulative e realizimit të tatimit mbi fitimin është dukshëm e përmirësuar në muajin mars (lëvizje e pritur sezonale) dhe paraqet 26.5%, që është pothuaj 1.5% nën ata 25% të barabartë, nëse ajo do të realizohej në mënyrë të barabartë në nivel mujor gjatë vitit. Vetëm në muajin mars norma e realizimit të tatimit mbi fitimin paraqet 16%.

### **Publikime publike në ueb faqet e Qeverisë dhe përdorues të zgjedhur buxhetor**

- ✓ Për dallim nga raportet paraprake kur ka pasur tendencë për ulje të numrit të publikimeve, në muajin prill, numri i publikimeve, në krahasim me raportin paraprak mujor, është rritur për rreth 13%.
- ✓ Mund të vërehet që ndonëse ka një numër të vogël të publikimeve tek përdoruesit buxhetor dhe përmbajtja e publikimeve është me të dhëna modeste sasiore dhe cilësore – gjegjësisht tek gjithë institucionet e monitoruar (tek ata që kanë ndonjë publikim në përgjithësi) përqindja e informacioneve të publikuar është shumë e vogël.
- ✓ Vetëm 27% të publikimeve të përgjithshme të Qeverisë së RM (që ka më së tepërmi – 75 publikime) përmbajnë të dhëna financiare për investimet e bëra/planifikuara.
- ✓ Vetë 3% të publikimeve të plota të gjithë përdoruesve buxhetor përmbajnë elaborim analitik të aktiviteteve të planifikuara/realizuara.
- ✓ Një pjesë modeste e publikimeve të gjithë përdoruesve buxhetor (rreth 10%) përfshijnë informacione për mjetet burimore, si dhe programet/strategjitë/planet në bazë të cilave e paralajmërojnë ose realizojnë projektin e publikuar.
- ✓ Vetëm 3 publikime të Qeverisë së RM përmbajnë çfarëdo analizë të publikimeve, ndërsa përdoruesit tjerë buxhetor në publikimet e tyre nuk kanë të dhëna thelbësore për aktivitetet e paralajmëruara.



- ✓ Pjesa më e madhe e publikimeve të gjitha ueb faqeve të monitoruar kanë të bëjnë me vizita, takime dhe konferenca të përfaqësuesve shtetëror, që kanë zhvilluar gjatë periudhës së raportimit.
- ✓ Nga monitorimi i strukturës-synimit të publikimeve të përdoruesve kryesor buxhetor vërehet që kryesisht kanë qenë të synuar: të rinjtë dhe të papunët (kryesisht me anë të prezantimit të masave për subvencion ose informim për përdorimin e tyre).
- ✓ Karakteristike është të përmendet që një pjesë e madhe e publikimeve kanë të bëjnë me subvencione, si për shembull projekti “Bli shtëpi për të rinjtë” (rreth 10% të publikimeve të plota), për të cilën vetëm më kishte një numër të publikimeve në periudhat e mëhershme të raportimit, si dhe publikime që kanë të bëjnë me subvencione. **Për këtë “projekt” pas një kontrolli paraprak të ueb faqeve zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Qeverisë së RM nuk janë gjetur informacione dhe të dhëna në ndonjë strategji përkatëse, program të qeverise ose ministrisë si dhe në programin buxhetor. Kjo ishte arsye që ishte kërkuar me KIKP, që edhe pas 3 muajve të skadimit të afatit ligjor, nuk kemi marrë përgjigje ende.**
- ✓ Ministria e Transportit dhe Lidhjeve dhe Ministria e Ekonomisë dhe Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore nuk kanë asnjë publikim, ndërsa Agjencia për Mbështetje Financiare në Bujqësor dhe Zhvillim Rural ka pasur një publikim që nuk përmban të dhëna financiare dhe burim të mjeteve.

### Monitorimi i shpenzimeve në nivel të pushtetit lokal

**Në këtë periudhë raportimi janë evidentuar në mënyrë kumulative gjitha shpenzimet në nivelin lokal, nga fillimi i monitorimit 01.01.2016.**

- ✓ Prej 01.01.2016-30.04.2016 janë vërejtur gjithsej 318 shpenzime buxhetore kapitale dhe operative në 24 komutat, për të cilat është nisur mbledhje plotësuese e të dhënave/informacioneve.
- ✓ Nga gjithsej shpenzimet e evidentuar (318%), për 58% gjegjësisht 186 shpenzime është dorëzuar KIKP ndërsa informacionet tjera janë fituar me kontakt të drejtpërdrejtë nga komuna ose informacionet kanë qenë të gatshme në ueb faqe.
- ✓ Nga të dhënat e gatshme të fituara nga grupi lokal i monitorimit, përcaktohet që numri më i madh i të dalave kapitale/operative në nivelin lokal janë identifikuar në Ohër, Strumicë

dhe Kumanovë, ndërsa më pak shpenzime janë identifikuar në Makedonski Brod, Çashka dhe Karbinci.

- ✓ Në lidhje me ndarjen kryesore të shpenzimeve operative dhe kapitale – pothuaj se tre të katërta të shpenzimeve të regjistruar kanë të bëjnë me investime kapitale (76% shpenzime kapitale dhe 24% shpenzime operative).
- ✓ Në lidhje me fushat e investimit si kryesore mund të ndahen: renovim/rindërtim të çerdheve, shkollave dhe objekteve tjera arsimore, rindërtim të rrugëve dhe rrugicave dhe rindërtim të rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit.
- ✓ Prej gjithsej 318 shpenzime të evidentuar në periudhën e monitorimit, 52 kanë të bëjnë me rindërtimin e rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit, 122 për rindërtim të rrugëve dhe rrugicave, 28 për rinovim/rindërtim të shkollave, çerdheve, shtëpive sociale etj., dhe 126 shpenzime që nuk mund të vendosen në kategoritë e lartpërmendura.
- ✓ **Prej gjithsej 318 shpenzime të evidentuar, për 204 prej tyre ka të dhëna të pjesshme ose të plota – gjegjësisht për rreth 36% të shpenzimeve të plota, monitoruesit ende nuk kanë siguruar informacione të qarta dhe konkrete dhe ende pritet përgjigje nga KIKP.**
- ✓ **Vetëm 7% të shpenzimeve të evidentuar<sup>1</sup> për të cilat ka së paku të dhëna minimale janë të parashikuar në ndonjë strategji të caktuar të ndonjë komune, 63% të shpenzimeve janë parashikuar në ndonjë prej programeve të komunës, 57% janë parashikuar me ndonjë program buxhetor, 41% të shpenzimeve janë parashikuar/bërë me vendim të këshillit, ndërsa 37% janë parashikuar në plan.**
- ✓
- ✓ **Vetëm 2% të shpenzimeve janë parashikuar/përmbajtur në gjitha 5 dokumentet, gjegjësisht në strategji, program, program buxhetor, vendim të këshillit dhe plan. 12% të shpenzimeve janë përfshirë në 4 dokumente, 30% janë parashikuar/përmbajtur në 3 dokumente, 18% në 2 dokumente dhe 23% në vetëm një dokument. Për 16% të shpenzimeve nuk ka të dhëna të qarta dhe të plota.**
- ✓
- ✓ **Për 39% të kërkesave të parashtruara është fituar një përgjigje në kuadër të afatit ligjor, për 40% të kërkesave pritet përgjigje (gjegjësisht ende nuk ka kaluar afati për përgjigje) ndërsa për 21% të kërkesave për qasje në informacione me karakter publik nuk është fituar përgjigje në kuadër të afatit ligjor.**

---

<sup>1</sup> Gjithsej 204 të dhëna të evidentuar të plota ose të pjesshme.

## 11. KORRESPONDENCA

Ekipet tona i ndoqën të gjitha aktivitetet me kërkesa me shkrim tek institucionet kompetente, me qëllim që të sigurojnë informata për shpenzimet e mundshme buxhetore. Në tabelën e mëposhtme, ju paraqesim letrat – KIKP, ku shfaqet përshkrimi i ngjarjes, rekomandimet dhe komentet dhe shpjegimet për shpenzimet e mundshme buxhetore. Vërejtje: Këtu janë shënuar letrat që i pranuar në prill, gjithsej janë dërguar 19 KIKP dhe kemi pranuar 14 përgjigje (përgjigja ka të bëjë me letrat për muajin mars të vitit 2016, kur janë dërguar 82 letra).

Ngjarja	Letra nr. jonë	Letër kthyesë nr.	Koment	Shënim (vërejtje)
Shpallje në faqen zyrtare të komunës së Shtipit dhe TV Star "Vazhdon rindërtimi i pjesës së dytë të rr.Vardarska (mjete nga komuna e Shtipit" ... -09.03.2016	0302-592-16. 03.2016	12-2751/2-11. 04.2016	Vendim për zbatim të procedurës së hapur-rindërtim të rr. "Vardarska", Shpallje për Marrveshje për FP, Pjesë e planit vjetor për FP për 2016 për komunën e Shtipit dhe Buxhetin-Vardarska.	
Në bazë të nenit 4 dhe nenit 12 prej Ligjit për qasje të lirë ndaj informatave me karakter publik prej "ISAR-Shtip" kërkohet:  - Plan vjetor për furnizime publike për 2016 për NP – punë komunale, prodhuese dhe shërbime "ISAR Shtip"  -Lista e furnizimeve publike të zbatuara dhe shpallura prej fillimit të viti 2016, me pranimin e kërkesës për qasje ndaj informatave me karakter publik	0302-588-16. 03.2016	postë elektronike pa nr. Arkivi/nr. jonë 0302-709-11. 04.2016		
Shpallje në portalin elektronik e-Magazin "ISAR punëson 59 punëtor" – 03.03.2016	0302-557-09. 03.2016	postë elektronike pa nr. Arkivi/nr. jonë 0302-709-11.		

		04.2016		
Shpallje e ueb faqes së komunës Qendër “Eko brigada për Qendër të pastër”- 20.03.2016	0302-626-22. 03.2016	11-1858/2-04. 04.2016	Plan vjetor për furnizime publike për 2016 për NP – punë komunale, prodhuese dhe shërbime “ISAR Shtip”	
Shpallje në faqen zyrtare të komunës Qendër “Rindërtimi i rr. Gjorgji Kapçev”-20.03.2016	0302-636-25. 03.2016	03-2228/2-06. 04.2014		
Shpallje në Fejsbuk faqen e komunës së Velesit “Projekt i ri për rinovim të SHMPK “Kole Nedelkovski”- 04.03.2016	0302-556-08. 03.2016	25-1690/2-08. 04.2016	Rregullore për organizim dhe sistematizim i vendeve të punës	
Ueb faqja zyrtare e komunës së Velesit “Nis vendosja e plakave në trotualet e qendrës së qytetit” – 11.04.2016	0302-721-15. 04.2016		Shpenzime të parapara sipas programit të miratuar të komunës Qendër për Planifikim urban “Φ” 2 për 2016, me realizim financiar sipas PFP për 2015, sipas programeve të votuara nga Këshilli i K. Qendër prej 17.12.2016, pa pagesë të kryer me vlerë të Kontratës prej 98.571.428,57-09.02.2016 nr.09-183/7	
Shpallje në ueb faqen e e-furnizimeve – Shpallje për Kontratë për furnizime publike nr.13/2016 Kryerje administrative e akteve drejtuese të miratuara (Rrënimimi i objekteve)	0302-723-15. 04.2016		Rindërtimi i rr. “Gjorgji Kapçev” është paraparë me PFP për 2016, shpenzimi është paraparë në buxhetin e komunës së Aerodromit nr.17/2015 f.14 në Gazetën zyrtare të Komunës së Aerodromit, <a href="http://www.aerodrom.gov.mk/sluzhben-glasnik">www.aerodrom.gov.mk/sluzhben-glasnik</a> , shpenzimi është paraparë në Programin J6-mirëmbajtje dhe mbrojtje e rrugëve dhe rrugicave lokale dhe rregullimi i regjimit Nënpikë 424320-Mirëmbajtje e autostradave, rrugëve dhe	



			rrugicave e publikuar në “Gazetën zyrtare të komunës së Aerodorimit nr.18/2015 f.16, PFP është në gazetën e njëjtë në f.22 Kontrata për mirëmbajtje-rindërtim të rr.Gjorgji Kapçev, nr.05-2129/1-24.03.2016 në vlerë prej 12 093 873,00 MKD, pa TVSH, pagesa është nëpërmjet pikës buxhetore dhe ende nuk ka pagesë.	
Shpallje në ueb faqen e komunës së Strumicës “Ishulli i luleve në parkun e madh të qytetit fitoi katin e ri”-10.04.2016	0302-722-15. 04.2016			
Shpallje në ueb faqen e komunës së Gostivarit “Lëshimi në përdorim i rrugës së sapo asfaltuar në f. Raven-07.04.2016	0302-725-1-1 8.04.2016			
Shpallje në ueb faqen e komunës së Gostivarit “Stadiumi i qytetit të Gostivarit me tribunë bashkëkohore me kapacitet për 100 shikues”-10.04.2016	0302-725-2-1 8.04.2016			
Shpallje në ueb faqen e komunës së Tetovës “Promocion i ueb-aplikacionit Unë për Tetovën- unepertetoven.com#tetovadigji tale( <a href="http://goo.gl/TA20fk">http://goo.gl/TA20fk</a> )-07.0 4.2016	0302-726-18. 04.2016			
Shpallje në faqen e NP ISAR në Fejsbuk “Vendosja e urrës për këmbësorë në fshatin Otinje”-16.04.2016	0302-734-1-2 2.04.2016			

Shpallje në TV lokale Star “Do të asfaltohet rruga deri në Suvo Grlo, Shtip”-13.04.2016	0302-7342-2 2.04.2016			
Shpallje në ueb faqen e sistemit elektronik të BFP “Pastrim i shtretërve të lumit Maxraça, Vrapçishtë dhe Topliçkë në territorin e komunës së Vrapçishtes”-15.03.2016	0302-763-3-2 5.04.2016			
Shpallje në ueb faqen e TV KISS “Njësia e punës “Parqe dhe gjelbërim” punon në pastrimin edhe rregullimin hortikulturor të hapësirave publike në Tetovë”-22.02.2016	0302-737-2-2 5.04.2016			
Shpallje në SE të BFP “Shpallje për mbledhje të ofertave për lëndën: Furnizim i materialeve për zyrë, formularëve, etj., për nevojat e NPK “TETOVO”-Tetovë-01.03.2016	0302-737-1-2 5.04.2016			
Shpallje në ueb faqen e komunës së Strumicës “NKVK Komunalec nis me rregullim të pikave kyçe në komunë”-22.04.2016	0302-738-1-2 5.04.2016			
Shpallje në ueb faqen e komunës së Strumicës “Vendosje e ndriçimit rrugor në rr.Gjorgji Vasilev” te varrezat e vjetra turke”-22.04.2016	0302-738-2-2 5.04.2016			
Shpallje në ueb faqen e SEBFP për mbledhje të ofertave për lëndën: Krijim i zgjedhjeve për marketing digjital për promovim të potencialeve turistike në Rajonin planifikues të Pollogut”-10.02.2016	0302-737-3-2 5.04.2016			
Shpallje në televizionin lokal Kanal Plus “Në Koçani u asfaltuan dhjetë rrugë me	0302—665-3	32-711/2-25.0		

paratë e Bankës botërore"-21.03.2016	1.03.2016	4.2016		
Shpallje në ueb faqen e Qeverisë së RM "Rindërtim i departamentit për hidroterapi dhe mjekësi fizikale në SHPQ "8 Shtetmври"-25.02.2016	0302-591-2-1 6.03.2016-Qe veria e RM-së  0302-594-16. 03.2016-M3	47-2711/4-14. 04.2016 Qeveria e Republikës së Maqedonisë  11-2466/3-25. 04.2016 M3		
Miting i mbajtur para Gjykatës Administrative në Shkup më 15.03.2016-KIKP-A është qyteti i Shkupit kompetent për lëshimin e lejeve për përdorim të hapësirës publike, a i ka dhënë leje partisë politike GDOM për mbledhjen e tyre dhe për çfarë kompensimi në para e ka dhënë.	0302-628-23. 03.2016	21-2396/1-29. 03.2016		
Shpallje në ueb faqen e komunës së Strumicës "Komuna e Gjevgjeliçës do të merr hua prej Bankës botërore pëe ndërtim të sistemit të ri për furnizim me ujë"-16.03.2016	0302-624-22. 03.2016	Kopja jonë nr. 0302-749-28. 04.2016- pa numër arkivi nëpërmjet postës elektronike	Kopje e huas afatgjate e komunës së Koçanit në suaza të projektit për përmirësim të shërbimeve komunale (MSIP), Programi për ndërtim dhe mirëmbajtje të rrugëve dhe rrugicave komunale në komunën e Koçanit për 2015	
Shpallje në Fejsbuk profilin e kryetarit të komunës Goranço Panovski –"Rruga e betonuar në komunën Çashka"-26.04.2016	0302-742-27. 04.2016			

## ANEKS



Fotografia 1. Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë Trajko Veljanovski



Fotografia 2. Kryetari i Republikës së Maqedonisë Gjorgje Ivanov



Fotografia 3. Revolucioni Iaraman – "PROTESTOJ"



Fotografia 4. Kontra protesti në Shkup-LQMM



Fotografia 5. Protesta të PDSH- Lëvizjes për reforma